

5. Mbështetja e stafit dhe studentëve në realizimin e hulumtimeve shkencore

- Sipas Statutit të Universitetit, për secilën thirrje akademike kërkohet një numër i caktuar i artikujve shkencor.
- Stafi i Universitetit inkurajohet që publikimet e tyre të realizojnë në revista të indeksuara kredibile ndërkombëtare, të indeksuara në databaza siç janë: WEB OF SCIENCES, dhe SCOPUS.
- UHZ brenda vitit organizon sesione informuese se si do të përkrahë financiarisht stafin akademik në pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare dhe publikim të punimeve shkencore.
- Më qëllim të mbajtjes së stafit akademik të njoftuar më përditësimet nga këto revista si dhe mënyrën e qasjes në këto revista, UHZ organizon sesione informuese të rregullta vjetore, si dhe individuale sipas kërkesës, për stafin akademik.

6. Hulumtimet e prezentuara dhe publikuara në revistat dhe konferencat shkencore

- UHZ do të përkrahë stafin e vet akademik që ka realizuar hulumtime shkencore cilësore, që t'i përgatisë dhe t'i publikojë ato hulumtime në revista shkencore ndërkombëtare serioze dhe të besueshme.
- UHZ do të shpërblejë publikimet e 5 punimeve me të mira.
- UHZ do të përkrahë së paku 10 publikime në revistën Web of science ose Scopus.
- UHZ do të organizojë nga 3 konferenca shkencore me karakter ndërkombëtar gjatë çdo viti.
- UHZ të krijojë dhe publikojë revistë shkencore multidisiplinare me karakter ndërkombëtarë 1 herë në vit, në përputhje me rregullat, procedurat kriteret dhe standardet ndërkombëtare për pranim, shqyrtim dhe publikim të punimeve shkencore.
- UHZ për çdo vit do të përkrahë anëtarë të stafit të vet akademik për të marrë pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare serioze që organizohen në shtete të ndryshme të botës, duke i mbuluar shpenzimet e stafit për pjesëmarrje në këto konferenca.

7. Menyra e hulumtimeve aplikative dhe organizimin e festivaleve dhe koncerteve artistike

- UHZ do të ndajë një linjë të veçantë buxhetore në baza vjetore, e cila do të shfrytëzohet për promovimin dhe përkrahjen e veprimtarisë dhe krijimtarisë artistike e kulturore të stafit dhe studentëve të UHZ-së brenda dhe jashtë vendit, e cila organizohet nga Fakulteti i Arteve të UHZ-së.
- Për çdo vit Fakulteti i Arteve të UHZ-së do të organizojë një festival ndërkombëtar.
- Për çdo vit UHZ do të përkrahë së paku 2 persona nga stafi akademik dhe 2 studentë të Fakultetit të Arteve të UHZ-së për të marrë pjesë në festivale të rëndësishme ndërkombëtare.
- Për çdo vit UHZ, përkatësisht stafi dhe studentët e Fakultetit të Arteve do të realizojnë së paku 5 koncerte brenda vendit dhe 3 koncerte në shtete të ndryshme të botës.
- Për çdo vit UHZ, përkatësisht stafi dhe studentët e Fakultetit të Arteve të UHZ-së, do ta organizojnë Javën Artistike Studentore, në kuadër të cilës do të ofrohen performanca dhe aktivitete të shumta e të ndryshme artistike e kulturore të përgatitura nga stafi dhe studentët e UHZ-së.

8. Indikatorët kryesorë të punës kërkimore


- Numri i publikimive.
- Numri i konferencave
- Numri i jurnaleve, platformave
- Numri i kontratave të bashkëpunimit
- Kontributi për Shoqërinë
- Përqindja e stafit në hulumtime
- Përqindja e buxhetit për kërkime
- Numri i granteve për hulumtime
- Numri i propozimeve të projekt-hulumtimeve
- Numri i citimeve të autorëve
- Renditja sipas faktorit të revistave dhe punimit të tyre
- Anëtarësimet në bordet e redaktimit kombëtar dhe ndërkombëtar
- Recensente (review) të brendshme dhe ndërkombëtare
- Numri i pjesëmarrësve,
- Numri i oreve në trajnime, workshope, seminare, prezentime,
- Shkalla e shfrytëzimit të mjeteve (salla leksionesh, klasa, salla e leximit, biblioteka, qendra e Internetit)
- Numri i punonjësve të graduar në titullin akademik më të lartë
- www.unhz.eu: Strategjia për kërkime shkencore 2020-2024
- <https://drive.google.com/file/d/11FD7-DU2YxelP-QNgxDIMNkh7gK8XUYg/view>



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Strategjia për kërkime
shkencore 2020-2024

Pejë, 2020



STRATEGJIA PER KERMIME SHKEN-CORE

1. Cili është qëllimi dhe çka është Strategjia për kërkime shkencore (SKSH) dhe a ekzistojnë burime të mjaftueshme për realizimin e saj?
2. Si bëhet identifikimi i nevojave të trajnimit dhe mbështetja për projekte hulumtuese dhe publikime në revista shkencore?
3. A ekziston qasja e nevojshme për të gjithë në platformat e hulumtimit?
4. Sa është ngritur bashkepunimi me universitetet/koleget ndërkombëtar në sferën e hulumtimit?
5. Sa mbështetëti stafi dhe student në realizimin e hulumtimeve shkencore dhe a ka mjete buxhetore të mjaftueshme?
6. A përfshihet hulumtimi në revistat dhe konferencat shkencore?
7. Sa është e zhvilluar menyrja e hulumtimeve aplikative dhe organizimin e festivaleve dhe koncerteve artistike?
8. Cilët janë disa prej indikatorëve kryesorë të punës kërkimore në nivel të universitetit?

1. Strategjia për kërkime shkencore (SKSH)?

- Strategjia për kërkime shkencore është një prej 4 objektivave kryesore të Universitetit "Haxhi Zeka".
- Qëllimi i SKSH, është që të zhvillojë kërkimet shkencore 30%, nga niveli i tanishëm deri në 2024 në UHZ, dhe të promovojë një mjedis të hapur intelektual në të cilin zhvillimi i hulumtimit shkencor është i bazuar në inovacion, dije dhe etikë dhe ka për synim zgjidhjen e problemeve të çështjeve komplekse me të cilat përballet sot shoqëria bashkohore

- Strategjia për kërkime shkencore parasheh në detaje aktivitetet që do të zhvillohen nga UHZ përmes stafit akademik dhe studenteve në fushën kërkimore, përfshirë përgatitjen e projekteve hulumtuese, realizimin e hulumtimeve shkencore e aplikative, publikimet në revista shkencore të besueshme, pjesëmarrjen në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare, etj
- Kjo strategji do të jetë në koherencë të plotë me Strategjinë gjithëpërfshirëse zhvillimore të UHZ 2020-2024.
- UHZ për çdo vit do të ndajë buxhet të veçantë për veprimtarinë kërkimore, përfshirë përgatitjen e projekteve hulumtuese, realizimin e hulumtimeve shkencore e aplikative, publikimet në revista shkencore të besueshme, pjesëmarrjen në konferenca shkencore ndërkombëtare në vlerë prej 1.200.000€ deri në vitin 2024.

2. Identifikimi i nevojave për trajnime dhe projekte hulumtuese

- UHZ përmes riorganizimit do të themelojë Zyrën për Kërkime Shkencore (ZKSH) në nivel të universitetit, e cila do të merret ekskluzivisht me promovimin e kërkimit shkencor, trajnimin dhe përkrahjen e stafit akademik për t'u marrë me veprimtari kërkimore.
- ZKSH çdo vit do të identifikojë konferencat shkencore me karakter ndërkombëtar që organizohen në Kosovë dhe do ta informojë stafin akademik të UHZ-së për këto mundësi dhe në të njëjtën kohë do të stimulojë pjesëmarrjen e tyre në këto konferenca.
- UHZ përmes ZKSH do të përzgjedhë 15 anëtarë të stafit akademik (nga 3 prej secilës njësi akademike) dhe 2 zyrtarët e Zyrës për Kërkime Shkencore, për të cilët do të ofrojë trajnime nga ekspertë ndërkombëtarë në lidhje me hartimin e projekteve hulumtuese.
- Organizimi i trajnimeve përmes ZKSH do behet edhe nga stafi i brendshëm i UHZ-së ku do të përfshihen së paku nga 5 anëtarë të stafit akademik nga secila njësi akademike (gjithsej 25 persona) për temat relevante të identifikuara prej stafit të UHZ..
- UHZ përmes ZKSH dhe nga Institutet e Hulumtimeve në nivel të njësive akademike, do të identifikoj fushat në të cilat secila njësi akademike për çdo vit do të hartojë 5 projekte hulumtuese.

3. Qasja e nevojshme për të gjithë në platformat e hulumtimit

- UHZ në përputhje me nevojat dhe kërkesat e stafit akademik, do të anëtarësohet dhe do të ofroj qasje pa pagesë për stafin e vet akademik në revista dhe databaza të hulumtimeve e publikimeve shkencore ndërkombëtare, si ato të përgjithshme dhe sipas fushave.
- Platformat elektronike për stafin akademik dhe studentet parashihen si në vijim:
 - Asociacioni i bibliotekave elektronike të Kosovës,
 - J-Store,
 - EBSCO,
 - Routledge,
 - Springer,
 - Elsevier etj.
- Deri me tani vetëm Asociacioni i bibliotekave elektronike të Kosovës na ka mundësuar qasjen në artikujt shkencor të publikuara në EBSCO.

4. Bashkepunimi me universitetet/koleget ndërkombëtar në sferën e hulumtimit?

- UHZ çdo vite do të përkrahë realizimin e 10 hulumtimeve shkencore, të cilat do të realizohen në bashkëpunim me disa profesorëve të UHZ-së dhe disa kolegëve të tyre nga universitete ndërkombëtare.
- UHZ çdo vite do të përkrahë realizimin e 10 hulumtimeve shkencore, të cilat do të realizohen në bashkëpunim me disa profesorëve të UHZ-së dhe disa kolegëve të tyre nga universitetet vendore në Kosovë.
- UHZ çdo vite do të përkrahë realizimin e 20 hulumtimeve shkencore, të cilat do të realizohen nga një grup profesorësh të UHZ-së.
- UHZ do të kërkojë nga secili anëtar i stafit të vet akademik që brenda një periudhe 1 vjeçare të realizojë së paku një hulumtim shkencor.
- UHZ do të realizojë së paku 5 hulumtime aplikative për çdo vit, të cilat do të financohen nga bizneset dhe kompanitë e interesuara.
- Përfshirja e studentëve në hulumtime shkencore dhe aplikative njëjshu do të përkrahët nga UHZ.
- UHZ do të kërkojë nga stafi akademik që të përfshijnë hulumtimet e tyre në përmbajtjet mësimore, në kuadër të të cilave do të flasin kërkimet shkencore që vet profesorët kanë realizuar apo janë përfshirë.
- Këto hulumtime, përveç sigurimit të fondeve përmes projektit, do të përkrahën financiarisht edhe nga buxheti i veçantë i UHZ-së për kërkime shkencore .